

Fjalë të Mëdha – Pjesa 6

Plot Fuqi

Mirë se erdhe në festimin e kishës sonë. Gëzohem që bashkohesh me ne javë pas jave. Si ka qenë kjo seri për ty?

Jemi në serinë "Fjalë të Mëdha", pjesa e 6-të. Javën tjetër është pjesa e fundit e serisë.

Fjalët sot janë: **Plot Fuqi**. Fuqia, energjia që vjen kur ke Jezu Krishtin.

Pasazhi nga Bibla që do të shikojmë së bashku është nga Veprat e Apostujve 3:1-10. Është një mrekulli e veçantë që ndodh në këto vargje. Doktor Luka, që shkroi librin e Veprave, e fillon duke përshkruar sesi filloi kisha e parë dhe si po rritej në mënyrë eksponenciale. Pastaj ka një moment, ky që do të lexojmë, kur Pjetri dhe Gjoni takojnë një lypës rrugës për në tempull, rrugës për në kishë.

Nga kjo histori do të shikojmë disa parime.

Së pari, është dëshira e Perëndisë që të jetojmë çdo ditë të jetës tonë Plot Fuqi. Perëndia na dha shpëtimin përmes Jezusit dhe nuk na la vetëm me kaq. Ai nuk tha: "Tani që e more shpëtimin, bëj ç'të mundesh, ec sa të mundesh." Por me fuqinë që Ai na jep, dëshiron dhe pret që të ndikojmë me jetët tona.

Kur ti zgjedh të besosh në Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar, fuqia e Frymës së Shenjtë banon në ty. Lutem që ky mesazh të jetë shumë nxites për secilin prej jush.

Veprat e Apostujve 3:1 *'Por Pjetri dhe Gjoni po ngjiteshin bashkë për në tempull, rreth orës së nëntë, në orën e lutjes.'*

Veprat e Apostujve 3:2 *'Dhe aty ishte një njeri i çalë që prej lindjes, të cilin e sillnin çdo ditë dhe e linin afër derës së tempullit, e t'u quajtur "E bukura", për t'u kërkuar lëmoshë atyre që hynin në tempull.'*

Ndoshta e ke lexuar shumë herë këtë pjesë ose e ke dëgjuar të predikuar nga shumë persona, por le të shikojmë nga perspektiva e Pjetrit dhe Gjonit, për të parë sesi fuqia e Perëndisë doli nga ata dhe ndikoi dikë.

Veprat e Apostujve 3:3-4 *'Ai, kur pa se Pjetri dhe Gjoni po hynin në tempull, u kërkoi lëmoshë. Atëherë Pjetri, me Gjonin, duke i ngulur sytë mbi të, i tha: "Na shiko".'*

Veprat e Apostujve 3:5 *'Dhe ai po i shikonte me kujdes, duke shpresuar se do të merrte ndonjë gjë prej tyre.'*

Veprat e Apostujve 3:6 *'Por Pjetri tha: "Unë nuk kam as argjend, as ar, por atë që kam po ta jap: në emër të Jezu Krishtit nazarenas, çohu dhe ec!".'*

Veprat e Apostujve 3:7 *'Dhe, si e kapi nga dora e djathtë, e ngriti në këmbë; dhe në atë çast iu forcuan këmbët dhe nyjat.'*

Veprat e Apostujve 3:8 *'Dhe me një të hovur u ngrit në këmbë dhe filloi të ecë; dhe hyri me ta në tempull, duke ecur, duke u hedhur dhe duke lavdëruar Perëndinë.'*

Kjo është një histori fantastike. Ja ku është dikush që po pret të marrë diçka të vogël, dhe Perëndia i jep më shumë se sa kishte pritur. Dëshmia e fuqisë së Jezus Krishtit është e gatshme të jepet, vetëm sepse iu ndryshua jeta një njeriu.

Veprat e Apostujve 3:9-10 *'Dhe gjithë populli e pa duke ecur dhe duke lavdëruar Perëndinë, dhe e njohën se ishte ai që rrinte ulur para derës së Bukur të tempullit për të kërkuar lëmoshë; dhe u mbushën me habi dhe çudi për atë që i kishte ndodhur atij.'*

Jeta e tij mori fuqi. Le të shikojmë së pari se ku ndodhi kjo mrekulli: te porta e tempullit. Shiko, ne shpesh presim që mrekullitë të ndodhin vetëm kur jemi në ndonjë ndërtesë kishë—pas predikimeve dhe lutjeve.

Por shumica e mrekullive nuk ndodhin në ndërtesën e një kishë, siç ndodhi kjo mrekulli. Gjasat janë që vendi ku mund të ndodhë një mrekulli është kudo ku je ti—në shtëpinë tënde, në punën tënde, në shkollën tënde, në lagjen tënde. Atje ku je ti, ka gjasa të ndodhë një mrekulli nëpërmjet teje.

Kthehemi te historia jonë: Pjetri dhe Gjoni po shkonin në kishë. Ky njeri, lypësi, ishte ulur te porta, hyrja. Dhe befasi, fuqia e Perëndisë doli nga dy burra të thjeshtë, te porta, dhe fuqizoi jetën e një personi.

Nuk ka rëndësi se ku je dhe se çfarë po bën. E vërteta është se Perëndia të ka pajisur me dhuntitë, aftësitë, pasionin dhe përvojat për të bërë diçka në emrin e Tij. Gjasat janë shumë të mëdha që Perëndia mund të përdorë ty për të ndodhur një mrekulli në jetën e dikujt, përpara se të fillojë predikimi. Aty ku je ti, aty ku ndodhesh ti, është prania e Perëndisë; fuqia e Perëndisë është në ty. Nuk është rastësi që ti je aty ku je.

Ti je pjesë e kësaj kishë, pjesë e shërbesave dhe e familjes së kishës, jo thjesht për të qenë spektator. Perëndia dëshiron që të përfshihesh dhe të jesh bekim për dikë. Ai nuk do që ti thjesht të dëgjosh diçka dhe kaq. Ai dëshiron që, me fuqinë që të jep Ai, të bësh diçka. Ndoshta ti nuk ke dhunti për të kënduar apo për të predikuar. Pjetri dhe Gjoni, as nuk kënduan, as nuk kërcyen, as nuk predikuan.

Ata thjesht i zgjatën dorën dikujt për ta ndihmuar; thjesht e preknin dikë dhe fuqia shëruese e Perëndisë doli prej tyre për personin në nevojë.

Dua të sfidoj personalisht secilin sot. Pyet veten: A jam gati që Perëndia të më përdorë jashtë portës së tempullit? A jam gati që Perëndia të më përdorë për të bekuar dikë?

A dëshiron të jesh **Lidhja e Fuqisë së Perëndisë**?

E ke parasysh rrymën elektrike? Prit se do bëj si elektriçist tani. Që të përcjellësh rrymë nga këtu atje, duhet një kabull, që e fut në prizë këtu dhe e con rrymën aty ku të duhet në anën tjetër.

Ne jemi si kjo lidhje, në mënyrë figurative, që përcjellim rrymën e Perëndisë nga këtu atje.

Jezusi vdiq që të na jepte jetë, të na mbushte me fuqinë e Frymës, që Ai të shkëlqejë nëpërmjet teje.

Ti je Lidhja e Fuqisë së Perëndisë.

Ti përfaqëson Perëndinë e Universit. Ti je bir/bijë i çmuar i mbretit të universit.

Disa herë na ngatërrohet ideja e kishës. Mendojmë se për të sjellë ndikim në emrin e Zotit Jezus, na nevojitet një kishë e madhe, duhet kjo, duhet ajo. Projekte, shumë lekë, shumë gjëra... Dhe fillojmë të nxjerrim justifikime.

"Ateherë, kur të jemi një mijë veta, atëherë kur të kemi këtë, atëherë kur të kemi atë. Se tani... Çfarë mund të bëj unë, se unë jam vetëm një person. Unë di kaq, kam kaq, mundem kaq..."

Në pasazhin që lexuam, ky njeri, lypësi, priste që Pjetri dhe Gjoni do t'i jepnin disa monedha, ndonjë 10 lekë - 20 lekë. Aq priste.

Veprat e Apostujve 3:5 *'Dhe ai po i shikonte me kujdes, duke shpresuar se do të merrte ndonjë gjë prej tyre.'*

Dhe më vjen natyrshëm të bëj një krahasim. Çfarë pritjesh ke kur vjen në festimet e kishës,? Ka shumë gjasa që shumë njerëz nuk kanë pritje fare.

Sepse festimet/shërbesat e kishave po na bëhen shumë të zakonshme. Kur unë them, "Le të kemi një jetë Plot Fuqi nga Perëndia," një lloj fuqie që vjen tek ne dhe del nëpërmjet nesh,

Do të Ndodhin Gjëra Përtej Pritjeve Tona.

Ai po priste disa monedha nga ata dy, por ata nuk kishin monedha me vete. Nuk e di nëse Pjetri dhe Gjoni ishin të varfër ose nëse nuk kishin marrë portofolin

me vete. Por ajo që dimë është se në atë moment nuk kishin asgjë. Për ta mund të kishte qenë e lehtë të thoshin: "Shiko, dua të ndihmoj, por nuk mundem." Dhe këtu ndalon shumica e njerëzve - "Dua, por nuk kam mundësi."

Kur na thërret Perëndia për të bërë diçka, për të shërbyer, dhënë ose për të vepruar, mendjet tona fillojnë të mendojnë menjëherë për atë që na mungon dhe që nuk na lejon të kryejmë atë punë. Nuk e fokusojmë vëmendjen te çfarë kemi, por te pse nuk mund ta bëjmë, pse nuk mund të japim.

"Nuk kam dhuntinë që më nevojitet, talentin që më duhet. Do ta kisha bërë, do ta kisha dhënë, por nuk kam."

Por pyetja nuk është, "Çfarë nuk ke?" Por "Çfarë ke?" Çfarë mund të japësh ti? Sepse Perëndia dëshiron që ti të ofrosh atë që ke.

A e ke dëgjuar këtë shprehje: "Mendo jashtë kutisë" (Think outside the box)? Mendo se çfarë mund të bësh nëse do të kishe këtë apo atë. Ideja është të motivojë të jesh krijues, novator, dhe të mendosh për mënyra të reja.

Dhe kisha duhet të jetë një vend i mbushur me talente, me novatorë dhe ide të reja gjithmonë, sepse ne përfaqësojmë Krijuesin e Universit me atë që bëjmë.

Unë dua të të jap një ide tjetër. Mendo për ato që ke brenda kutisë. Kutia është e kufizuar, sepse ka anë dhe është e limituar. Ndoshta je i limituar me kohën, financat, edukimin e duhur, ose për shkak të një të shkuare copë-copë. Nuk e di sesi ka qenë e shkuara jote, por ajo që dua të them është: Nëse mendon jashtë kutisë, po harxhon shumë kohë dhe energji. Po mbushesh me shpresa boshe që mund të të pengojnë dhe të të bëjnë të mos veprosh.

"Sikur të kem këtë, atëherë do të shërbej. Kur të kem kaq, atëherë do të jap. Kur të jem i zot, e zonja... Sa të mbaroj shkollën, sa të lidhem, sa të martohem, sa të filloj punë, sa të bëj 2-3 fëmijë, sa të mbarojnë fëmijët shkollën, sa t'i martoj, sa të dal në pension. Jo, sa të vdes."

E di kur ndodhin mrekullitë dhe kur jeta jote mbushet Plot Fuqi: kur shikon dhe përdor ato që ke në kuti. Kur e fillon me atë që ke. Ndoshta nuk i ke të gjitha dhe nuk i di të gjitha, por ti ke disa gjëra që Perëndia të ka dhënë. Ka disa mënyra sesi mund të shërbesh. Ka diçka që ti mund të japësh.

Si Pjetri dhe Gjoni, unë dua të nxis ty sot. Mos u kufizo me atë që nuk ke. Ata thanë, "Lekë s'kemi. Por kemi diçka tjetër—Fuqinë e emrit e Jezusit. Dhe në emër të Jezusit, cohu dhe ec." Kur bëhen bashkë ato pak gjëra që kam me çdo gjë që ka Perëndia, ndodhin mrekullitë. Prandaj të them, shiko se çfarë ke në kuti, çfarë ke sot në dorë.

Kush e mban mend mrekullinë te Mateu 14? Jezusi kishte qenë duke iu shërbyer njerëzve gjithë ditën, dhe një turmë e madhe e rrethoi. Ata ishin shumë të uritur, dhe dishepujt thanë: "Jezus, a t'i largojmë që të ikin? Sepse nuk kemi më çfarë t'i ushqejmë, janë shumë."

Ata panë jashtë kutisë: "Jezus, janë mbi 5 mijë burra, përveç grave dhe fëmijëve. Ku kemi aq lekë për t'i ushqyer?"

Çfarë iu tha Jezusi? "S'ka gjë, e di që s'keni, është fund muaji, sa keni paguar qiranë, sa keni paguar këstin e kreditit, sa keni bërë furnizimet e muajit. S'ka gjë, e di që s'keni." Por Jezusi nuk iu tha kështu. Ai iu kërkoi: "Çfarë keni në kutinë tuaj? Çfarë keni tani në dorë?"

5 bukë dhe 2 peshq. Dhe Jezusi iu dha të njëjtën përgjigje që na thotë të gjithëve ne. Të njëjtën gjë që bëri Pjetri dhe Gjoni, që u bënë lidhës të fuqisë së Jezusit.

Jezusi tha: "Më sillni atë që keni!" Pyetja nuk është, çfarë nuk ke, çfarë nuk mund të bësh. Pyetja është: A do ta sjellësh para Jezusit atë që ke, që Ai të bëjë diçka që vetëm Ai mund ta bëjë?

Kur ne bëjmë atë që mundemi dhe Perëndia bën atë që vetëm Ai mund të bëjë, ndodh mrekullia. Çfarë ndodhi? Kush e di historinë, Jezusi mori atë që i sollën, u lut për të, e bekoji dhe iu tha dishepujve ta shpërndanin. "Shërbeju njerëzve me atë që ke." Çfarë ndodhi? Mrekullia ndodhi. Me atë pak që ishte në dorën e Jezusit, u ushqyen mijëra njerëz dhe mbeti edhe teproi ushqim.

Si mund të të përdorë Perëndia ty? Si mund të bësh diçka në emër të Jezusit? Si mund të kesh një jetë Plot Fuqi?

Kur e sjell para Perëndisë atë që ke, atë që je dhe i thua: "Zot, ja ku jam. Zot, ja ku e kam. Me dorë hapur. Më përdor mua. Me këto që kam sot. " Sille para Tij.

"Zot, nuk është shumë, por po ta sjell ty. Zot, nuk kam shumë kohë të lirë gjatë javës, por këto 2-3 orë që kam, po ti sjell ty. Zot, nuk kam shumë talente, dhunti, përvoja, por këto 2 gjëra që di ti bëj, po ti sjell ty. Zot, kam më shumë histori dështimi se histori sukcesi, por këtë që kam po ta sjell ty."

"Nëse do të më përdorësh, ja ku jam. Nëse do që të shërbej, ja ku jam. Nëse do që të them thjesht një fjalë inkurajimi, ja ku jam. Nëse do të nisësh diçka të re në mua, ja ku jam."

Mos u anko për ato që nuk ke, por sill para Tij atë që ke. Dhe shiko sesi Perëndia do ta shumfishojë, shiko sesi fuqia e Tij do të veprojë nëpërmjet teje.

Unë jam këtu, kush jam: **Jam lidhës, jam përcjellës i fuqisë së Krishtit.**

Unë bëj pjesën time me atë që kam, Perëndia bën pjesën e Tij me atë që ka. Dhe aty ndodh mrekullia.

Fuqia e Krishtit le të mbushë jetën tënde tani dhe gjatë gjithë kësaj jave, dhe le të dalë nga ti; përcille fuqinë e Tij tek dikush tjetër.

Efesianëve 3:20 *'Tani atij që, sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë,'*

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.